



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar .

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Luan Harusha, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Alban Zeneli , Arben Elezi

Mungojnë:

Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi, Anduel Xhindi

Të ftuar :

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi - Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave

Agim Muslia- Drejtor i Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave

Gloria Çarkaxhiu – specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore
në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Mund ta fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, meqenëse edhe kuorumi është i plotë.

Në rendin e ditës kemi njoftuar shqyrtimin në parim të dy projektligjeve: “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar” dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar .

Sikundër është bërë me dije edhe në mbledhjen e fundit të këtij komisioni, këto dy ligje dhe ligji që bën fjalë për administrimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, janë paketa e ligjeve që kompletojnë masat që kanë të bëjnë me luftën kundër pastrimit të parave dhe njëkohësisht reflektojnë edhe të gjitha rekomandimet, që i janë drejtuar shtetit shqiptar, përkatësisht Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Pastrimit të Parave nga Komiteti Manival. Shqipëria është e detyruar t’i plotësojë këto rekomandime brenda verës së këtij viti dhe ne si parlament kemi angazhimin dhe detyrimin tonë që brenda këtij sesiioni t’i realizojmë të gjitha ndryshimet e propozuara.

Kemi bërë vetëm prezantimin në parim të ligjit për administrimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe sot kemi menduar të ecim me dy ligjet e tjera të paketës në parim, me qëllim që ditën e nesërme t’ia kushtojmë kalimit nën për nën.

Theksoj që ne nuk jemi komision përgjegjës për secilin nga këto projekte, por komision për dhënie mendimi. Drejtoria e Pastrimit të Parave është një institucion që raporton në Komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe besoj se do të na nevojitej të kishim edhe ne një informacion të plotë dhe të përfshiheshim në diskutimin e të tri projektligjeve.

Sot kemi të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që, në fakt, është edhe propozuesja i këtyre projektligjeve, zotin Elton Haxhi, zëvendësministër. Faleminderit për prezencën!

Kemi të ftuar gjithashtu edhe përfaqësuesen e Ministrisë së Drejtësisë, zonjën Gloria Çarkaxhiu, specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore.

Ishte njoftuar të ishte prezent sot edhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, i cili është vënë në këtë detyrë ditët e fundit. Besoj që do të jetë këtu më vonë, për shkak të angazhimeve që ka.

Mund të çelim diskutimin. Sipas Rregullores së Kuvendit, fjalën do t'ua jap të ftuarve për të bërë një prezantim të projektligjit të parë dhe më pas relatorit të projektligjit për të thënë edhe ai qëndrimin e komisionit.

Faleminderit!

Zoti Haxhi, fjala për ju.

Elton Haxhi – Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Siç e prezantoi kryetarja në mënyrë të përgjithshme, kemi të bëjmë me një paketë ligjore që adreson disa rekomandime që ka lënë Komiteti Manival për Shqipërinë vitin që kaloi. Në muajin korrik të vitit të kaluar ky komitet miratoi raportin e raundit të pestë të vlerësimit të kuadrit institucional ligjor dhe rregullator në vendin tonë në drejtim të zbatimit të 40 rekomandimeve ndërkombëtare të grupit të posaçëm të veprimit financiar shkurtimisht FATF, në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë periudhës 2016-2018 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave është angazhuar në mënyrë intensive në udhëheqjen dhe koordinimin e këtij procesi të vlerësimit të vendit, i cili në rëndësinë e tij ka qenë tejet kompleks dhe kërkonte përfshirjen e koordinimit të një sërë institucionesh publike, por edhe angazhimin e sektorit privat.

Nga ky raportim rezultojnë si të përmbushura plotësisht 28 rekomandime, 10 rekomandime janë të përmbushura pjesërisht dhe 1 rekomandim është i papërmbushur. Krahasuar me raundin paraardhës të vlerësimit të vitit 2010, ka një përmirësim të ndjeshëm në aspektin teknik të rekomandimeve.

Për sa i përket efektivitetit, rezultati është në përputhje me mesataren e vendeve të vlerësuara nga Komiteti Manival. Nga 11 rezultate imediate, 2 janë vlerësuar me efektivitet substancial, 7 me efektivitet të moderuar dhe 2 me efektivitet të ulët.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet vlerësimi dhe efektiviteti substancial i punës së Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave në cilësinë e njësisë së inteligjencës financiare, si dhe efektiviteti i masave parandaluese të ndërmarra nga subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, konkretisht i referohet sistemit bankar.

Sidoqoftë, në këtë drejtim ka disa sfida në fusha të rëndësishme, të cilat duhet të adresohen dhe të trajtohen në mënyrë të detajuar. Me qëllim adresimin sa më të shpejtë të këtyre rekomandimeve, në datën 4 shtator 2018 është krijuar Komitetit i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, i kryesuar nga Kryeministri.

Në zbatim të rekomandimeve, është hartuar një plan masash dhe kjo paketë ligjore ka si synim adresimin e një sërë rekomandimeve, të cilat janë të përcaktuara edhe në planin e masave.

Këto ligje që kemi sot, por edhe ato që keni kaluar ju në seancat e mëparshme janë plane masash, të cilat duhen adresuar në mënyrë imediate. Konkretisht, janë parashikuar që të miratohen prandaj edhe kanë hyrë me procedurë të përshpejtuar brenda këtij muaji, qershor 2019.

Nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit sa më të shpejtë të projektligjeve synojmë të sigurojmë një përputhshmëri në rritje për pjesën teknike dhe atë të efektivitetit në sistemin parandalues në vendin tonë.

Përmbushja brenda një kohe sa më të shpejtë e të gjitha mangësive të evidentuara është e një rëndësie të veçantë, siç e theksova, dhe kërkon angazhim ndërinstitutional në mënyrë që të sigurojmë një përputhshmëri në rritje në aspektin teknik dhe atë të efektivitetit. Këto do të sigurojnë edhe shmangien e procedurave të monitorimit të thelluar nga ana e FATF-së, gjë që do të kishte efekte të ndjeshme për vendin tonë.

Projektligji i parë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka bërë disa ndryshime në mënyrë të përmbledhur, të cilat konsistojnë në disa shtesa në përcaktimin e personave të ekspozuar politikisht. Më konkretisht, është shtuar një pjesë, e cila ka të bëjë me rezidentë të huaj, që punojnë si kryetarë të organizatave të huaja në vendin tonë. Gjithashtu, ka përcaktuar një afat për personat e ekspozuar politikisht, i cili është vendosur 5 vjet. Ka disa përkufizime të reja, ku një prej tyre ka të bëjë me mjete virtuale apo me *cripto assets*, të cilat janë një zhvillim teknologjik i kohëve të fundit, kështu që ligji duhej përditësuar me këto zhvillime dhe ka disa përcaktime të tjera, të cilat mund t'i diskutojmë në trajtimin nen për nen.

Pak a shumë ky ishte prezantimi, por, nëse ka pyetje në lidhje me dy paketat, jam i gatshëm të përgjigjem.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Gjykoj të ndalemi hap pas hapi, së pari, të merremi me ndryshimet që propozoni në ligjin për masat kundër financimit të terrorizmit. Lufta kundër terrorizmit është

një prioritet i kohëve që po jetojmë jo vetëm për vendin tonë, por në përgjithësi për gjithë botën e qytetëruar në të cilën jetojmë, kështu që është shumë e rëndësishme që kuadri i masave që bëjnë të mundur parandalimin e financimit të terrorizmit përmes veprimtarive të ndryshme kriminale, tek e fundit edhe përmes financimit të terrorizmit synojnë të pastrojnë para, bëhet shumë e rëndësishme.

Mesa kuptuam nga fjala juaj, jo vetëm që u reflektuan të gjitha rekomandimet e Manivalit, por në të njëjtën kohë bëhet e mundur që veprimi i Drejtorisë së Pastrimit të Parave dhe institucioneve të tjera të përfshira në këtë luftë bëhet më i menjëhershëm, njëkohësisht rriten masat dhe zgjerohet edhe rrethi i subjekteve dhe i pasurive në drejtim të të cilave aplikohen këto masa.

Megjithatë, për diçka më tepër, do të doja t'ia kaloja fjalën relatorit, zotit Duzha dhe pastaj kolegët mund të drejtojnë pyetje për të qenë sa më të orientuar për masat shtesë që propozohen.

Luan Duzha - Faleminderit, zonja kryetare!

Siç e theksoi edhe zëvendësministri, qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi nën kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë, si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës.

Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet:

1. Zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të politikave nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit.
2. Parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarive kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë, ose zbulimi dhe raportimi i tyre.
3. Zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrimin e parave, financim të terrorizmit.

Me këtë projektligj synohet përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimi i 6 i grupit të posaçëm të veprimit financiar FATF, kriteret përkatëse të këtij rekomandimi, si dhe rezultati imediat i elementëve të vlerësuar si pjesërisht të përmbushur.

Vlen të evidentohet rëndësia e posaçme e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimi 6, pasi është në grupin e atyre që konsiderohet kyçe në sistemin parandalues dhe goditjes ndaj terrorizmit dhe financimit të tij.

Zbatimi i rekomandimeve të FATF-së, të cilët, përveçse janë botërisht të pranuar dhe ka mekanizma ndëshkimi, në rastet e mosndjekjes dhe zbatimit për vendin tonë, kanë forcë juridike të shtuar, pasi janë detyrime që rrjedhin edhe nga neni 13 i konventës së Këshillit të Europës, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 6946, datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”. Gjithashtu, hartimi i projektligjit është miratuar si detyrë dhe përparësi në datën 04.09.2018 nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave, i kryesuar nga Kryeministri dhe me anëtarë të të gjitha organeve relevante të fushës.

Ndaj, i ftoj kolegët që ta miratojmë.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Duzha!

Fjala është për kolegët.

Zoti Murrizi ka kërkuar fjalën.

Myslym Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, do të doja që të ishte këtu Drejtori i Drejtorisë së Pastrimit të Parave, që është edhe autoriteti i drejtpërdrejtë që merret edhe me paratë e pista që hyjnë në vendin tonë, edhe të atyre që konsiderohen si para që shkojnë për financimin e terrorizmit nga strukturat ligjzbatuese, por edhe për ta pyetur për diçka konkrete. Nuk e di sa i disponueshëm është zëvendësministri!

Nëpërmjet medieve (por që tashmë nuk është më *live*, është një akt i konsumuar përderisa ka edhe një vendim gjykatë), jemi bërë me dije që në Shqipëri kanë ardhur dy vëllezër indianë, që janë bërë konsuj nderi dhe Presidenti u ka dhënë pasaportë diplomatike. Ata ndiqeshin për pastrim parash të pista në Indi dhe i kanë sjellë këto miliona euro këtu te ne. Ata gati-gati na konkurruan për të na zënë vendet bosh, deri sa iu dhanë pasaportat diplomatike e na u bënë konsuj nderi. Tani nuk e di ç’është bërë me ta, janë në arrest shtëpie?

Ndaj thashë që drejtori duhet të dinte ndonjë gjë...

Erdhi drejtori?

Ermonela Felaj - Në fakt, sapo na është bashkuar në mbledhje edhe zoti Elvis Koçi, që është Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave. Më duhet ta justifikoj për shkak të një përplasjeje në orare, sepse janë disa komisione që duhet të merren me shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

Ndjesë, zoti Murrizi! Besoj se tani keni të gjitha mundësitë të ripërsërisni pyetjen tuaj dhe të marrësh një përgjigje nga drejtori.

Myslym Murrizi – Faleminderit!

Zoti Drejtor, meqë po diskutojmë ligjin për masat kundër financimit të terrorizmit, por edhe për pastrimin e parave të pista, pjesa tjetër pastaj e aseteve të sekuestruara nuk është se influencon kaq shumë në politikën shqiptare dhe sigurinë, sa këto dy të parat, kisha një pyetje konkrete: çfarë informacioni ka pasur autoriteti që drejtoni, pavarësisht se ju keni ardhur rishtaz aty, lidhur me vëllezërit indianë, që në Indi akuzoheshin apo janë nën akuzë për pastrim parash? Këtu kanë marrë pasaportë diplomatike të firmosur nga ministri i Jashtëm dhe janë dekretuar nga Presidenti si konsuj nderi të pastrimit të parave të pista të Indisë, se kështu i bie.

Fakti që sot kemi një vendim gjykate, njëri prej tyre ruhet me polic në arrest shtëpie, se është pa qejf, tjetri nuk dihet se ku ndodhet, doja të dija a ka ndonjë informacion lidhur me këtë? Sa vërehet nga institucioni juaj fenomeni i vëllezërve indianë, kinezë, rusë, çek, bullgar, të cilët vijnë dhe bëjnë aktivitete, se indianët nuk kanë ardhur thjesht për të marrë një pasaportë këtu, di që kanë edhe një marrëdhënie kontraktuale biznesi për një resort turistik në Jug, që u është shitur atyre me paratë që vijnë vërdallë. Keni ndonjë dijeni, apo jo?

Po për terrorizmin keni ndonjë të dhënë konkrete? Ka para që futen në Shqipëri nga kanale të ndryshme apo janë para të faktorit shqiptar, të biznesit shqiptar, para shqiptarësh që vijnë nga jashtë, që shkojnë për financimin e terrorizmit?

Ndoshta jam i gabuar, se mbase po i fryjmë kot financimit të terrorizmit nga shqiptarët, se të kishim kaq para për të financuar terrorizmin, nuk do të iknin nga 200-300 mijë veta jashtë për të gjetur punë në Gjermani apo gjetkë. Vijnë para të pista, nga të huajtë, apo shqiptarët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nëse nuk vijnë nga shqiptarët, atëherë këtë fenomenin e indianëve e kam fort merak. A e kanë më ata pasaportën diplomatike? A do të vazhdojnë të jenë këtu? Mos janë bërë të mëdhenj, dreqërit, e na bëjnë dekret? Nuk kam asgjë me ta, janë burra të nderuar, po t'i kenë lekët e pastra. Halli është të mos vijnë të na kandidojnë për president këtu, dhe flasim kot ne që bëjmë ligje për lepujt e vegjël?!

Pra, sa informacione të kesh, duke qenë se ke vetëm një javë që ke filluar aty, na i thuaj. Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Murrizi!

Zoti Koçi, fjala për ju. Pyetja është konkrete në rast se ju keni një përgjigje për pyetjen, sikundër edhe nëse rasti konkret që parashtroi zoti Murrizi lidhet me ndonjë nga masat e propozuara në ligjin për masat kundër financimit të terrorizmit.

Elvis Koçi – Ju falënderoj për pyetjet!

Për rastin e vëllezërve indianë, në veçanti, sot nuk kam me vete informacionin e duhur për t’iu përgjigjur pyetjes specifike, por në përgjithësi për t’iu përgjigjur pyetjes në sektorin e ndërtimit ku ata operojnë dhe si është tipologjia e çështjeve që ne trajtojmë në këtë sektor, ajo që mund të them është se ne i kemi përfshirë tashmë kompanitë e ndërtimit në listën e subjekteve, të cilat janë subjekte raportuese për ne. Kemi bërë trajnime me ta dhe po e forcojmë gjithnjë e më shumë raportimin, në mënyrë që pastrimi i parave nëpërmjet tyre të mos jetë i mundur në Shqipëri. Pra, jemi në fazën që po i trajnojmë, po i kontrollojmë dhe po i monitorojmë.

Ndërsa në veçanti, për emrat konkretë nuk e di nëse agjencia që drejtoj ka pasur informacion dhe nuk mund të them as po, as jo, sepse nuk jam i informuar.

Për sa i përket pyetjes së dytë për financimin e terrorizmit, Shqipëria, në dijeninë time, nuk është vend tipik ku konsumohet terrorizmi dhe as vend tipik nga ku nisen luftëtarët apo edhe fondet për të bërë terrorizëm në një vend tjetër. Sigurisht që në të shkuarën kemi pasur raste që i kemi trajtuar për terrorizëm, luftëtarë të huaj, por me pjesën e financimit të terrorizmit duhet të kuptojmë që nuk bëhet fjalë për shuma të mëdha, por edhe për shuma të vogla. Pra, edhe sikur një biletë avioni, e cila shkon për të financuar udhëtimin e dikujt për të kryer terrorizëm apo për blerjen e materialeve që shërbejnë për terrorizëm, është shumë e rëndësishme në këtë rast. Ajo që ne kemi sjellë si ndryshim këtu, në fakt, është një pjesë e ligjit ekzistues, i cili na mundëson që ne të reagojmë shpejt në harkun e orëve, jo më me ditë, kur ka listime të reja në listat e Kombeve të Bashkuara, gjë që na mundëson të veprojmë menjëherë për këto raste pa një njoftim paraprak. Ky është ndryshimi i vetëm madhor që ne bëjmë te ligji për masat kundër financimit të terrorizmit, i cili nuk ka të bëjë me shumatat e mëdha, por ka të bëjë me shpejtësinë e reagimit dhe nëse emrat që janë rishtazi aty dalin edhe te subjektet që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Elton Haxhi – Përveç ndryshimit ligjor drejtoria është duke punuar me të gjithë aktorët e tjerët për një vlerësim kombëtar risku, i cili do të ndihmojë në krijimin e disa profileve që janë me risk të lartë në lidhje me financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave. Ndërmjet të tjerave

është edhe një rekomandim i Manival-it, por kjo do të jetë si një strategji apo si një vlerësim kombëtar, i cili do të ndihmojë më pas edhe në fushën e monitorimit apo të kontrollit më të detajuar nga të gjitha agjencitë ligjzbatuese.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Haxhi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të asaj që tha kolegu Murrizi, kisha një pyetje sa u takon organizatave fetare. A janë subjekt i juaj fondet që financohen këto organizata dhe se si përdoren këto fonde?

Elton Haxhi – Kjo është një fushë që ne e kemi në konsideratë, sepse ka qenë edhe një rekomandim tjetër jo për organizatat jofetare, por në përgjithësi për OJF-të, të cilat kërkojnë një vëmendje të shtuar pikërisht për financimin e terrorizmit, nuk bëhet fjalë për pastrim parash, por bëhet fjalë për financim të terrorizmit, gjë, të cilën e përmendi edhe drejtori. Unë nuk jam në dijeni për detajet, por nga lajmet kemi dijeni që ka pasur përfshirje të disa organizatave jofitimprurëse në këto financimet e vogla, të cilat duhet të konsiderohen si me risk të lartë dhe objekt i mbikëqyrjes.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve po punon për marrjen e një informacioni nga të gjitha organizatat jofitimprurëse dhe për krijimin e një metodologjie specifike për kontrollin e këtyre organizatave jofitimprurëse. Sipas një udhëzimi të ministrit Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për kontrollin e organizatave jofitimprurëse. Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave është në kuadrin e përgjithshëm dhe merr informacione nëpërmjet kanaleve institucionale, siç janë ato bankare apo të tjera për transaksione të ndryshme, por transaksionet e vogla janë të vështira për t'u identifikuar ndoshta edhe nga sistemi bankar, pasi bëhet fjalë për shuma të vogla dhe pagesa kesh, pasi jo gjithmonë kemi pagesa nëpërmjet kanaleve bankare. Kjo është një fushë që kërkon një vëmendje të shtuar, megjithatë nga ajo që tha edhe drejtori, ne nuk jemi një vend i rrezikshëm në këtë aspekt, gjithsesi duhen marrë disa masa për ta forcuar mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse.

Ermonela Felaj – Zoti drejtor, keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar sa i takon pyetjes?

Më pas fjalën e ka zoti Zeneli.

Elvis Koçi – Një nga rekomandimet e vlerësimit të Manival-it ka qenë edhe ndërtimi i regjistrit të organizatave jofitimprurëse, ku futen edhe ato me karakter fetar dhe ne aktualisht

jemi duke punuar dhe po bashkëpunojmë ngushtë edhe me Qendrën Rajonale kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe jemi në hapat e parë, në dijeninë time është siguruar financimi dhe jemi duke ndërtuar edhe këtë regjistër, i cili do të na mundësojë edhe monitorimin më të mirë të organizatave fetare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Më falni, zoti Zeneli, sa për të plotësuar pyetjen!

A kemi paraprakisht një numër të këtyre organizatave që ju pyeti zoti Duzha nga ju apo jeni ende në fillim?

Elton Haxhi – Ne nuk e kemi ende një numër të saktë, por në dijeninë time nuk ka një regjistër elektronik. Pra, Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë, e cila është institucioni ku të gjitha organizatat jofitimprurëse regjistrohen, nuk ka mbajtur një regjistër elektronik dhe kjo gjë e bën të vështirë nxjerrjen e statistikave. Ne mund të nxjerrim statistika nga organi tatimor për ato organizata që janë të pajisura me NIPT, që janë të regjistruara aty, por këtu nuk është e gjithë popullata, pasi mund të ketë edhe organizata që nuk kanë pasur nevojë ta përdorin NIPT-in dhe kanë vepruar thjesht me regjistrimin në gjykatë. Nëse do të kemi mundësi të komunikojmë në ndonjë moment tjetër, do t'i sigurojmë këto statistika.

Ermonela Felaj – Besoj se gjatë ditës së nesërme, meqenëse do të bëjmë edhe kalimin nën për nen të projektligjit.

Fjalën e ka zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Normalisht, çdo projektligj që vjen në Komisionin e Sigurisë në lidhje me masat për financimin e terrorizmit është shumë i rëndësishëm për ne dhe në parim, ne si pjesë e opozitës jemi dakord. Unë dua të di nga ju, zoti zëvendësministër dhe nga drejtori i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave se si e keni parashikuar ju në ligj parandalimin e pastrimit të parave për financimin e terrorizmit, sepse ka raste, siç edhe ju e theksuat që kjo bëhet me shuma jo të konsiderueshme, por me shuma shumë të vogla gjë, të cilën edhe sistemi bankar e ka shumë të vështirë për t'i monitoruar dhe për t'i parë nëse edhe këta janë pjesë e financimit të terrorizmit. A keni ju asete apo ligji e ka parashikuar se si do t'i parandaloni?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zeneli!

Fjalën e ka zoti Haxhi.

Elton Haxhi – I gjithë sistemi bankar ka rregulla të qarta se si i monitoron të gjitha subjektet që kanë një risk të lartë për financim të terrorizmit apo për pastrim parash. Përveç kësaj, siç jua thashë, në fushën e organizatave jofitimprurëse është e përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pasi ata kanë më shumë burime njerëzore për të bërë një kontroll në terren. Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave nuk i ka këto burime njerëzore që të dalë në terren dhe të bëjë kontroll për subjekte të caktuara, por kujdeset për një sistem të tërë të subjekteve, të cilat janë të detyruara nga ligji për të bërë monitorimin e këtyre dy aktiviteteve që ju sapo përmendët. Këtu mund t’ju përmend noterët, të cilët janë subjekt i ligjit, kontabilistët, audituesit ligjorë dhe sistemin bankar, që është një nga ato struktura, e cila ka marrë edhe një vlerësim substancial edhe nga raporti i Manival-it, për efektivitetin e punës që ata kryejnë në këtë aspekt.

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi – Pjesa e financimit të terrorizmit është vepër penale më vete, pavarësisht se paratë mund të jenë edhe të pastra, por e rëndësishme është nëse po financohet terrorizëm, por edhe pse kjo vepër penale është e mëvetshme nga terrorizmi, prandaj duhet trajtuar me seriozitetin e duhur.

Pra, nëse dikush shkon si luftëtar i huaj dhe mund të trajtohet në pjesën e terrorizmit, financimi i udhëtimit të tij, i armatimit të tij apo çfarëdolloj gjëje tjetër është vepër penale më vete. Kjo gjë duhet hetuar dhe duhet bërë në bashkëpunim me strukturat e tjera ligjzbatuese në momentin që luftohet një rrjet i tillë kriminal. Ajo ku ne bashkëpunojmë është mundësia jonë për të aksesuar *data bazën* e bankave, të shoqërive të transfertave dhe për të vërtetuar që indiciet e para merren nga fusha. Në momentin e parë që kapet rrjeti pyeten se nga i kanë burimet dhe më pas verifikohen nëpërmjet kanaleve tona. Në këtë rast duhet patjetër një bashkëpunim më i ngushtë me strukturat e tjera, pasi ne të vetëm nuk mund të arrijmë të bëjmë shumë nëse nuk kemi bashkëpunim me strukturat e policisë.

Ermonela Felaj – Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti drejtor!

Unë jam në dijeni se si financohet në Shqipëri pjesa terroriste, sepse kam qenë pjesë e strukturave të shërbimit sekret dhe normalisht ata lëvizin me para kesh. Pyetja ime ishte si e keni parashikuar ju dhe në çfarë mase është bashkëpunimi juaj, sidomos me Shërbimin Sekret Shqiptar, sepse ata kanë mundësi dhe asete që ju nuk i keni?

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi – Fatkeqësisht, sa i takon pjesës së lëvizjes kesh, ne si agjenci nuk arrijmë dot ta kontrollojmë, por bazohemi te autoritetet e Policisë Kufitare dhe autoritetet e tjera. Sa i takon bashkëpunimit me SHISH-in, ne kemi letërkëmbim dhe shkëmbim informacioni pothuajse të përditshëm dhe ato informacione që disponojmë i ndajmë me SHISH-in.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zotin zëvendësministër dhe drejtorin e Drejtorisë së Pastrimit të Parave për informacionin e dhënë!

Unë kam një pyetje për ju. Gjatë vitit 2018 dhe deri tani a ka pasur raste të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit? Nëse po, cilat janë masat që keni ndërmarrë ju si agjenci?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Mirë se erdhët zoti Muslia!

Në fakt, ne kemi qenë disa herë në kontakt me ju për informacionet që na keni dhënë për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe të Pastrimit të Parave.

Fjala për ju.

Agim Muslia – Përshëndetje, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë,

Të dhënat e detajuara statistikore janë të publikuara në raportin vjetor të drejtorisë, i cili mund të shkarkohet nga faqja zyrtare.

Ermonela Felaj – Në fakt, zonja Dhima nuk ka qenë anëtare e këtij komisioni, kështu që edhe pyetja e saj vjen nga kjo gjë, por nëse mund të kemi diçka më konkrete mendoj se do të na vlente. Unë mendoj se ngjarje të tilla janë ngjarje që mbahen mend, prandaj mendoj se mund të veçojmë diçka nga aktiviteti i pastrimit të parave që ka shkuar për financim të terrorizmit, nëse ka pasur gjatë vitit 2018.

Agim Muslia – Me lejen tuaj, zonja kryetare, mund t’ju jap shifra totale të parave që janë dërguar në agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit, përkatësisht në Policinë e Shtetit dhe në Prokurori. Për vitin 2018 janë gjithsej 376 raste, ku pjesa më e madhe është dërguar në Policinë e Shtetit dhe 33 raste janë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme. Pjesa dërmuese e këtyre rasteve

ka qenë për dyshimet që ne kemi pasur për pastrim të produkteve të veprës penale, ndërkohë që ka pasur edhe raste të dyshuara për financim të terrorizmit, por këto nuk janë mbizotëruese.

Me lejen tuaj, ditën e nesërme ne mund të sjellim një kopje të raportit, ndoshta me të dhëna më të detajuara, të cilat do t'i marrim sot shënim.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Unë do të doja të ndaja me kolegët diçka që u tha këtu, që financimi i parave dhe financimi i terrorizmit qëndrojnë më vete si dy veprimtari, të cilat i dëgjon ligji penal. Terrorizmi në vetvete mund të financohet me para që vijnë nga aktivitete kriminale, sikundër mund të financohet me para që nuk vijnë nga aktivitete kriminale. Në Kodin Penal është zhvilluar goxha nocioni i zhvillimit të terrorizmit, sepse ka shkuar edhe drejt terroristit të vetëm. Pra, ne sot nuk duhet të imagjinojmë që aktet terroriste kryhen nga një organizatë kriminale, pasi edhe një individ i vetëm mund të shndërrohet në terrorist, duke marrë përsipër të kryejë secilën nga ato akte që ne sot e konsiderojmë si akte terroriste ose të marrë përsipër edhe financimin e terrorizmit.

Ndërkohë, po i rikthehem zotit Koçi, por edhe zotit Muslia, i cili ka një përvojë të gjatë tek institucioni në fjalë. Ju jeni mirëfilli propozuesit e këtij projektligji, por edhe për kolegët që erdhën pak më vonë në mbledhje, masat që ju propozoni në ligjin për masat kundër financimit të terrorizmit, si e ndihmojnë konkretisht punën tuaj? Ku kishit pengesa ju më parë dhe si këto masa që ju propozoni e lehtësojnë punën tuaj? Pra, duke u shprehur për këto çështje të gjithë do të arrijnë të kuptojnë drejtpërsëdrejti se ku konsistojnë masat që ju keni marrë.

Agim Muslia - Faleminderit, për pyetjen!

Me lejen tuaj, do të vijoj me përgjigjen e kësaj pyetje. Në referencë të standardeve ndërkombëtare rekomandimi kryesor që ne synojmë të përafrojmë është rekomandimi 6-të i FATF-së, i grupit të posaçëm të veprimit financiar. Një nga mundësitë kryesore që është evidentuar në raportin e fundit të Komitetit Manival të Këshillit të Europës, ka të bëjë me mangësitë që sistemi parandalues në Republikën e Shqipërisë ka në drejtim të ngrirjes pa vonesë të fondeve të personave të dyshuar si financues të terrorizmit. Këtu bëhet fjalë për personat e shpallur nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vijim të rezolutës 1267.

Në fakt, vendi ynë që prej vitit 2004 ka treguar që ka marrë masa, të cilat janë vlerësuar në vijimësi për zbatimin e këtyre rezolutave, besoj se ju mund të jeni në dijeni që ka pasur edhe bllokime të fondeve të personave të shpallur, siç ka qenë rasti i Jasin Kadi, por edhe të personave

të tjerë, të cilët dyshoheshin për kryerje të veprave terroriste. Ajo çfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij projektligji është që në momentin e shpalljes së një personi në nivel ndërkombëtar ne të jemi në gjendje brenda vendit që së bashku me të gjitha subjektet e ligjit, por edhe me çdo person, që ka detyrimin të konstatojë marrëdhënie financiare apo marrëdhënie të natyrës tregtare me personat e shpallur, të sigurojmë një ngrirje të menjëhershme të këtyre fondeve, aseteve në mënyrë që të jemi në përputhje sa më të plotë me standardet ndërkombëtare. Ky është qëllimi kryesor, i cili është shpjeguar edhe në relacionin përkatës që ne kemi paraqitur për këtë qëllim. Ne mendojmë se nëpërmjet miratimit të këtij projektligji do të sigurojmë një përputhshmëri në rritje, pasi së shpejti pritet që ne të paraqesim edhe një informacion të detajuar pranë Komitetit Manival të Këshillit të Europës dhe zbatimi i rekomandimit 6-të, është i një rëndësie të veçantë, edhe për faktin se në kaluarën Shqipëria ka qenë subjekt i një monitorimi të thelluar, kujtoj këtu vitet 2012-2015, i cili ka qenë i lidhur me mangësitë që ishin konstatuar atë kohë për zbatimin e këtyre rezolutave.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Dua të di diçka për procedurën e deklarimit të të hollave në momentin që kalon pikat e kalimit kufitar. A ka ndryshuar sot kjo procedurë apo vijon të ngelet e njëjtë? Për këtë pjesë shoh që në ligj ka një ndryshim, a mundeni të na e përshkruani më hollësisht dhe cili ka qenë qëllimi?

Elton Haxhi – Faleminderit!

Ne kemi pasur një limit të hollash, i cili nuk ishte në përputhje me vendet e tjera dhe bënte të mundur që një shumë, e cila deklarohet këtu, nuk deklarohet në shtetin tjetër, pasi nuk e kalonte limitin prej 10 mijë eurosh ose kundërvlerën e tij, që është i përcaktuar në shumicën e vendeve të rajonit, por edhe më gjerë. Për të bërë unifikimin e kësaj vlere në projektligjin përkatës është propozuar që të jetë vlera 10 mijë euro, ose kundërvlera e saj në mënyrë që edhe informacioni të kryqëzohet midis vendit të nisjes dhe atij të mbërritjes.

Ermonela Felaj - Nëse do të kemi 10 mijë euro e sipër jeni të detyruar t'i deklaroni. Po formati i deklarimit është i njëjtë me atë të vendeve të tjera? A ka një unifikim të formati i deklarimit të të dhënave apo jo?

Agim Muslia – Për sa i përket formatit të deklarimit që në fillesat e tij ne jemi bazuar në formatin që përdoret në BE. Pra, në vetvete formati nuk ka ndryshim thelbësor, përveç pragut të raportimit që përmendi zoti zëvendësministër.

Ermonela Felaj - Po, zoti Koçi.

Elvis Koçi - Këtu theksin nuk po e vëmë te rritja e limitit, por te masat administrative që pasojnë moszbatimin e këtij detyrimi për të deklaruar shumat mbi limit. Deri sot në legjislacion nuk kemi pasur të parashikuar masa administrative. Është hera e parë që parashikohen masat administrative për ata që nuk e kryejnë deklarin, pasi jo gjithmonë mosdeklarimi mund të përbëjë vepër penale dhe ndiqet sipas Kodit Penal, por sa herë që ka mosdeklarim të shumave mbi vlerën, ne po fusim konceptin e gjobës.

Ermonela Felaj - Në fakt, ne e pamë ndryshimin dhe gjoba është proporcionale në varësi me shumën nga 10 mijë euro e sipër.

Zoti Murrizi kërkon t'i rikthehet pyetjes që bëri në fillim të mbledhjes.

Myslim Murrizi – Sa informacion keni? Indianët (dy vëllezërit indianë) me valixhe i sollën paratë apo me llogari bankare?

Meqenëse zoti Koçi është i ri në detyrë mund të përgjigjet kush të dojë, nuk ka problem. Indianët që akuzohen, i sollën paratë me thes, me valixhe, nuk i deklaruan në doganë apo i sollën me llogari bankare?

Elton Haxhi - Zoti Murrizi, fatkeqësisht nuk mund t'i përgjigjem pyetjes suaj, sepse unë mbaj pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Përputhshmërisë, ndërkohë që çështja është trajtuar nga Drejtoria e Analizës. Çështja që trajtoni në pyetjen tuaj është një funksion që është mbuluar nga drejtori i Drejtorisë së Analizës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Nga drejtori ne morëm përgjigje, megjithatë nëse nuk ka një përgjigje sot, mund të kemi një përgjigje nesër.

Elton Haxhi – Është një rast konkret, por ne nuk e kemi këtu informacionin. Nëse na jepet mundësia do ta sjellim në një seancë tjetër. Brenda limiteve që i lejon ligji për të dhënë informacion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju kuptoj.

(Zoti Murrizi flet pa mikrofon)

Myslim Murrizi - Unë që po të pyes kam certifikatë sigurie.

Nëse nuk e di, thuaj nuk e di. Ajo nuk është më sekret. Të anulojmë mbledhjen...

Ermonela Felaj - Zoti Murrizi!

Elvis Koçi - Ju dhashë përgjigje, edhe drejtori ju dha përgjigje.

Ermonela Felaj - A mund t'i qetësojmë pak tonet?

Myslim Murrizi - Të dalin jashtë ata që nuk kanë certifikatë sigurie.

Ermonela Felaj – Dakord! Vetëm se u tha që personat, të cilët janë paraqitur nuk e kanë këtë përgjigje. Nesër do ta kemi këtë përgjigje.

(Zoti Murrizi flet pa mikrofon)

Nuk u tha që nuk e japim këtë përgjigje, se mbledhja është me dyer të hapura, por u tha : “ Nuk e kemi këtë përgjigje, sepse ne kemi ardhur për ligjin dhe jo për një rast konkret”.

A mundemi që këtë përgjigje ta përgatisni nesër edhe pse kjo del jashtë propozimit për të cilin ne jemi mbledhur? Dakord? Dua të kuptoni diçka.

Zoti Haxhi ju lutem!

Në këtë komision ka ndjeshmëri në këtë pikë, sepse anëtarët e këtij komisioni janë të pajisur rregullisht me certifikatë sigurie. Pra, le të jemi edhe ne joevazivë, të mos pretendojmë se e dimë, por nuk e themi, pasi rregullat janë të ndërtuara të tilla që ne mund të ndajmë gjëra që janë konfidenciale në momentin që informacioni është. Në rast se informacioni nuk është, ju lutem, sigurojeni dhe nesër meqenëse ne do të mbledhemi sërish ta kemi atë. Këtu mund t'i mbyllim të gjitha diskutimet për këtë pikë.

Kalojmë në miratimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Gjatë ditës së sotme, stafi i Komisionit të Sigurisë duhet të vërë në dispozicion të të gjithë deputetëve tabelën me ndryshime dhe amendimet që janë propozuar në Komisionin e Sigurisë, me qëllim që nesër të jemi sa më efektivë. Janë 12 nene që propozohen të ndryshojnë, më saktë 11 nene, sepse neni 12 është “Hyrja në fuqi” në ligjin bazë për projektligjin “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar” .

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Luan Harusha, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Alban Zeneli , Arben Elezi

Mungojnë:

Elena Xhina, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi, Anduel Xhindi

Të ftuar :

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi - Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave

Agim Muslia- Drejtor i Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave

Gloria Çarkaxhiu – specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Ermonela Felaj - Kalojmë në prezantimin e projektit tjetër, bëhet fjalë për disa ndryshime të tjera që janë bërë në një ligj që daton që nga viti 2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”. Këto ndryshime shkojnë bashkë. Çdo masë që propozohet për të nxitur dhe për të ashpërsuar luftën kundër financimit të terrorizmit, pastrimit të parave, duhet të prekë edhe ligjet ku bazohet ose orientohet kjo luftë.

Relatore nga Komisioni i Ligjeve është zonja Gjebrea.

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi - Nuk kemi ndonjë gjë për të shtuar. Prezantimin e bëmë që në fillim. Ai është kuadri i përgjithshëm që janë ndërtuar këto dy ligje. Në këtë ligj nëse do të kalojmë nën për nën, mund të kalojmë në një përshkrim të përgjithshëm të ndryshimeve që kemi propozuar, që kanë synim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Manival dhe futjen e disa koncepteve të reja, të cilat nuk janë në ligjin ekzistues, sanksione të reja dhe shtrirjen në afate kohore për sa u përket personave të ekspozuar politikisht në lidhje me vigjilencën e thelluar.

Ermonela Felaj - Ju lutem, na e sqaroni pak këtë moment, sepse edhe nga diskutimet që kemi pasur në komisionet e tjera, kemi parë se ka një vëmendje të shtuar në këtë pikë. Pra, të na sqaroni më konkretisht se çfarë sjell, se diskutimi në parim për ju që e prezantoni projektin e përfshin edhe përmbajtjen nën për nën, sepse të diskutimi nën për nën, më tepër fjala është për kolegët sesa për propozuesit e ligjit.

Elton Haxhi – Për personat e ekspozuar politikisht kemi shtuar një përcaktim në lidhje me personat e huaj, rezidentë të huaj, të cilët konsiderohen të ekspozuar politikisht nëse janë kryetarë të organizatave të huaja, si dhe rrethi i tyre i afërm, i cili është i përcaktuar në ligjin “Për deklarimin e pasurive”. Aty janë të përcaktuara se cilët janë personat e afërm dhe personat e lidhur.

Në lidhje me afatin, nuk kemi pasur një afat të përcaktuar për kohëzgjatjen për largimin nga detyra për personat e ekspozuar politikisht. Në këtë projektligj është propozuar që të jetë 5 vjet. Sipas konstatimit të Manival-it rezulton se është 1 vit dhe ky është konstatuar si një afat shumë i shkurtër dhe është rekomanduar zgjatja e këtij afati. Ne kemi një propozim për 5 vjet.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ka diçka tjetër për të shtuar nga të ftuarit e tjerë?

Po, zoti Muslia.

Agim Muslia - Me lejen tuaj, zonja kryetare dua të them se janë shtuar edhe elemente të vigjilencës së thjeshtuar në zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare. Në projektligj kjo është një risi që na ndihmon që përveçse të rrisim nivelin e përputhshmërisë me standardet, të sigurojmë një nivel në rritje të qasjes së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel vendi, mbi bazën e riskut.

Jo të gjithë klientët që vendosin marrëdhënie biznesi me subjektet e ligjit, duke filluar që nga bankat e nivelit të dytë, zyrat e këmbimit valutor dhe një sërë profesionesh të tjera, do të konsiderohen me risk. Ky ka qenë qëllimi ynë që vëmendja e sistemit të përqendrohet në rastet që janë me risk të mesëm apo të lartë, ndërkohë që për rastet që konsiderohen me vigjilencën e thjeshtësuar niveli i monitorimit të jetë pak më i ulët. Po ju jap një shembull, nëse e vetmja pagesë që merr në llogarinë bankare një pensionist është pensioni, ky përbën subjekt monitorimi me vëmendje më të reduktuar krahasuar me një person tjetër që ka transaksione të shpeshta që nuk përkojnë me profilin e tij financiar. Kjo ishte risia që doja të shtoja, krahas atyre që përmendi edhe zoti zëvendësministër.

Një element tjetër ka të bëjë me mjetet virtuale dhe me ofruesit e shërbimeve virtuale. Kohët e fundit ka pasur një ndryshim të rekomandimit përkatës të FATF-së. Në kuadrin e amendimeve ligjore që ne kemi paraqitur sot është menduar, që të bëhet përafrimi edhe me këtë rekomandim, që është rekomandimi 15 i FATF-së. Në vendin tonë jemi ende në fazat kur shërbime të tilla janë pothuajse inekzistente, por është menduar që t'u paraprijmë zhvillimeve që do të ketë në të ardhmen në mënyrë që edhe këto subjekte nëse do të ofrojnë shërbime në Republikën e Shqipërisë, të jenë subjekt i ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Muslia!

Zonja Gjebrea fjala është për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju falënderoj, zoti Zëvendësministër dhe të nderuar drejtorë!

Në radhë të parë i urojmë suksese drejtorit të ri në punën e tij!

Besoj se edhe për ju si zëvendësministër është prezantimi i parë në këtë komision.

Gjithsesi, në lidhje me ligjin në fjalë këtu u theksua rëndësia që kanë pasur rekomandimet e Komitetit Manival të Këshillit të Europës. Në këtë komision është raportuar

për këto rekomandime dhe ne gjithashtu kemi kryer vizita monitoruese në Drejtorinë e Pastrimit të Parave dhe më vjen mirë që të gjitha rekomandimet kanë gjetur tashmë zbatim në përmirësimin e kuadrit ligjor edhe me këtë set që vjen për propozim të ne.

Të gjitha rekomandimet për sa i përket përputhshmërisë teknike janë të pasqyruara dhe ky projektligj që na vjen përmbush një pjesë të rekomandimeve me fokus ato që janë vlerësuar nga Komiteti Manival i Këshillit të Europës si të paplotësuar apo të përmbushura pjesërisht.

Qëllimi i këtij projektligji, siç u shpjegua edhe nga zoti zëvendësministër është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen dhe sigurinë.

Dëshiroj të theksoj shkurt vetëm rëndësinë që ka në funksion të këtij qëllimi, ku synohet:

Zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit.

Parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe i fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre.

Zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave, financimin e terrorizmit, si dhe dënimi e zhveshja e autorëve nga përfitimet e paligjshme.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e grupit të posaçëm të veprimit financiar, i cili përcakton standardet dhe nxit zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative, operationale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Theksoj se ky është një projektligj shumë i rëndësishëm dhe pa dyshim kërkon edhe diskutimin nën për nën që do të zhvillohet nesër, i cili është përcaktuar sipas kalendarit të punës së Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ka një ndërhyrje për procedurë nga zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi - Zonja kryetare, e dëgjova me vëmendje parashtrimin që bëri zoti zëvendësministër për projektligjin në fjalë. Kemi të bëjmë të paktën me sa pashë, me dy projektligje që kanë lidhje me rekomandimet që harmonizojnë legjislacionin shqiptar me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Meqenëse nesër do ta shqyrtojmë projektligjin nen për nen mendoj që ta miratojmë sa më shpejt. Kolegët kanë dëshirë të bëjnë pyetje, por mendoj se ne i kemi ezauruar edhe në ligjin e parë dhe besoj se pyetjet kanë shteruar.

Ermonela Felaj – Megjithëse kjo nuk ka të bëjë më tepër me procedurën sesa është një sugjerim për kolegët, por gjithsesi nuk mund të ndërpres kolegët nëse ata kanë nevojë të bëjnë pyetjet për të ezauruar që sot njohjen për projektin që jemi duke diskutuar.

Nëse dikush nga kolegët do të drejtojë pyetje, atëherë patjetër është i lirë që ta kryejë këtë gjë.

Ne sot i kemi të ftuarit, do t'i kemi edhe gjatë ditës së nesërme, që të mbyllim diskutimin nen për nen. Gjykoj se do të kemi edhe më tepër pyetje, sepse do të kemi edhe drejtorin e Agjencisë për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Nëse nuk ka më pyetje nga kolegët, shpresoj që nesër të mund të ezaurojmë momente të tjera të veçanta të projektit, duke përsëritur edhe një herë detyrimin për stafin e komisionit që të na bëjë të mundur vendosjen që sot në dispozicion të tabelës së ndryshimeve për të kuptuar se ku konsiston çdo njeri nga ndryshimet e propozuara.

Mbyllim këtu mbledhjen e komisionit, duke njoftuar se mbledhja tjetër do të jetë nesër për miratimin nen për nen të të tria projekteve që përbëjnë këtë paketë.

Besoj se njoftimi vlen edhe për ju, që të mos kemi përplasje dhe të jemi në kohë që raporti i komisionit tonë t'i shkojë edhe komisionit përgjegjës që është Komisioni i Ligjeve, pasi planifikohet që ditën e enjte këto projekte do të kalohen edhe në seancën plenare.

Kush është dakord në parim me ndryshimet e propozuara në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”? Kundër ? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj zotërinj përfaqësues të Ministrisë së Financave për bashkëpunimin gjatë ditës së sotme!

Mirë u takofshin nesër!

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA